



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 229, Datë 15.11.2021

MBI

MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR SHËRBIMIN E RIGAZIFIKIMIT PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË GNL-SË

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neneve 13; 16, pika 1, dhe nenit 32, pika 1 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 140/1 prot., datë 09.11.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi miratimin e Metodologjisë së llogaritjes të tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së”.

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 269, datë 28.12.2020, bordi i ERE-s vendosi, fillimin e procedurës për shqyrtimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së”.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u bë publikimi në faqen e web-it të ERE-s i vendimit të bordit të ERE-s nr. 269/2020 si dhe me shkresën e ERE-s nr.6/4 prot., datë 08.01.2021 u krye njoftimi në median e shkruar, dhe u bë botimi i këtij vendimi në Fletoren Zyrtare me nr. 9, datë 19.01.2021.
- ERE, me shkresën nr. 38 prot., datë 11.01.2021 ka njoftuar të gjitha palët e interesit si: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK), “Albgaz” sh.a., “Albpetrol” sh.a., “Phoneix Petroleum” sh.a, “C.G.C” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “Tap Ag Albania” sh.p.k., “GSA” sh.p.k. dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.
- Në përfundim të afateve me qëllim marrjen e opinionëve dhe propozimeve në lidhje me “Metodologjinë e përcaktimit të tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së”, rezultoi se:
 - Sekretariati i Komunitetit të Energjisë me emailin e datës 20.01.2021 ka dërguar komentet e tij mbi Metodologjinë

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 25/2 datë 23.04.2021 shprehet se: *“kjo procedurë është në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016”.*
 - Shoqëria “Albgaz” sh.a., përcolli komentet e saj me shkresën nr. 11/1 prot., datë 01.05.2021, protokolluar në ERE me nr. 39/2 prot., datë 15.02.2021.
- Ndryshimet që pësoi drafti i metodologjisë mbas diskutimeve në seancën dëgjimore online të datës 20.05.2021, midis përfaqësuesve të shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe Drejtorive Teknike të ERE-s, u ridërguan për konfirmim në mënyrë elektronike më datë 11 Qershor 2021 pasi u shqyrtuan edhe pyetjet, komentet dhe sugjerimet e bëra nga përfaqësuesi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
 - Metodologjia e llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së, është ripërgatitur në këndvështrimin e unifikimit të saj me aktet e tjera rregullatore të miratuara si dhe praktikat e mëparshme të ndjekura nga ERE, duke reflektuar komentet e palëve të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Metodologjisë së llogaritjes të tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së. (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.